

RAPORT KATËR MUJOR I MONITORIMIT
Degradimi natyror dhe urbanistik
Mars 2013, Prizren

PËRMBAJTJE

I. Përmbledhje Ekzekutive	2
II. Degradimi i trashëgimisë natyrore	4
III. Degradimi urbanistik brenda qytetit	6
IV. Konstatime të përgjithshme mbi trasnparencën	8
V. Të gjeturat specifike të monitorimit	10
VI. Rekomandime	13
VII. Aktivitetet/raportimi	14
VIII. Ndikimi i projektit	15
IX. Për projektin	16
X. Pse monitorimi i transparencës	17
XI. Falënderim	18
EC Ma Ndryshe	19

Ky raport është përgatitur në kuadër të projektit “Transparenca online e komunës së Prizrenit”, i përkrahur financiarisht nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë



British Embassy
Prishtina

I. Përmbledhje ekzekutive

Raporti i titulluar “Degradimi Natyror dhe Urbanistik” përmban brenda vetes punën katër mujore (dhjetor 2012 dhe janar, shkurt e mars 2013) të monitorimit të ekzekutivit lokal në kuadër të projektit “Transparenca online e komunës së Prizrenit”. Kjo analizë ndonëse përfshin zhvillimet në dikastere të ndryshme të qeverisë komunale të Prizrenit, një përqendrim të veçantë ia kushton aktualitetit urbanistik në Prevallë, me një vështrim retroaktiv edhe në ndërtimin e pakontrolluar brenda qytetit dhe në Qendrën Historike.

Urbanizmi, nga njohësit e kësaj fushe, përshkruhet si mënyra karakteristike e ndërveprimit të banorëve të qyteteve apo qytezave me mjedisin e ndërtuar, në të cilat infrastruktura dhe objektet vihen në shërbim të përmirësimit të ambientit jetësor dhe shërbimeve publike. Për fat të keq, ky koncept nuk ka gjetur vend në politikat publike të qeverisë komunale, që kanë të bëjnë me urbanizimin dhe planifikimin hapësinor, si brenda qytetit ashtu edhe në zonat e veçanta natyrore.

Periudha e pasluftës dhe tranzicioni në përgjithësi kanë sjellë me vete zhvillim të pakontrolluar edhe në Prizren, që është manifestuar me çintegrim urban, planifikim të pa-balancuar hapësinor, humbjen e tokës bujqësore e deri te degradimi i trashëgimisë natyrore në zonat rurale. Mungesa e transparencës në vendimmarrje dhe vënia e pushtetit në krah të grupeve të caktuara të interesit, qoftë nga biznesi apo politika, në kurriz të ambientit jetësor të qytetarëve ka bërë që qyteti dhe zonat e mbrojtura natyrore të përfshihen nga një kaos urbanistik shkatërrimtar, pasojat e të cilit do të jenë afatgjate.

Rasti më i dhimbshëm padyshim se është ndërtimi i fshatit turistik në Prevallë, i realizuar me “aminin” e autoriteteve të komunës së Prizrenit dhe të Ministrisë së Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor të Qeverisë së Kosovës. Kjo zonë e cila dikur është vlerësuar si bukuri natyrore tani është shndërruar në një shëmti betoni dhe manual se si ushtrohet krimi urbanistik. Madje degradimi ka shkuar aq larg sa që as Prokuroria Themelore nuk ka mundur më të qëndroj indiferente kundruall këtyre zhvillimeve negative. Dhe ndonëse Prokuroria i ka nisur hetimet në bazë të dyshimeve për keqpërdorim të mjeteve të dedikuara për rregullimin e infrastrukturës në Prevallë, autoritetet komunale të Prizrenit kanë miratuar konkluzionin për ri-tenderimin e projektit për rregullimin e infrastrukturës në fshatin turistik Prevallë.

Gjatë hulumtimit disa javor në lidhje me Prevallën, EC Ma Ndryshe ka konstatuar parregullsi të shumta të Qeverisë komunale në raport me transparencën në zbatimin e projektit për rregullimin e infrastrukturës në Prevallë. Me javë të tëra monitoruesit e EC Ma Ndryshe kanë tentuar që të sigurojnë kontratën dhe dosjen përcjellëse të projektit “Ndërtimi me koncesion i infrastrukturës në fshatin turistik Prevallë”. Pas gjithë këtyre kërkesave, EC Ma Ndryshe ka pranuar një njoftim të shkurtër nga DUPH-ja në lidhje me kërkesën për qasjen në dokumentet publike. Në këtë shkresë DUPH-ja bën të ditur se “KK Prizrenit implementon këtë projekt sipas participimit të pronarëve gjatë marrjes së lejeve ndërtimore” dhe se një operator privat ekonomik i ka realizuar punimet sipas kontratës përkatëse derisa “KK Prizrenit nuk e financon këtë projekt”. Po ashtu bëhet e ditur se “projekti është ende në fazën e implementimit”. Për shkak të mungesës së kontratës dhe dosjes në

përgjithësi, sikurse edhe paqartësive të shumta sa i përket mënyrës së zbatimit të këtij projekti, EC Ma Ndryshe e ka pas të pamundur që të nxjerr një konstatim të qartë mbi rrjedhën e zhvillimeve në këtë projekt. Në të njëjtën kohë mungesa e transparencës së duhur nga zyrtarët përgjegjës komunal ka bërë që të ngritën edhe dyshime mbi rregullsinë e kontraktimit dhe zbatimit të projektit, të cilat duhet të zbardhen deri në fund nga organet e drejtësisë.

Shqetësimet në lidhje me gjendjen e krijuar në fshatin turistik të Prevallës, ku ndërtimet po vazhdojnë pa respektimin e lejeve të ndërtimit të dhëna nga DUPH-ja si dhe për ri-tenderimin e projektit që është nën hetime, janë përforcuar me raportin e shtatë drejtorive në lidhje me gjendjen në kampingun e Prevallës, ku sipas të dhënave të organeve komunale kontrata e menaxhimit të kampingut ka skaduar që nga data 15 maj 2011. Të gjeturat e komisionit përkatës komunal, që janë përshkruar në procesverbalin e hartuar pas pesë takimesh, dëshmojnë për gjendjen skandaloze dhe alarmante në këtë zonë.

Krahas fokusit për zhvillimet në Prevallë, gjatë periudhës raportuese monitoruesit e transparencës së qeverisë komunale kanë hulumtuar edhe çështje tjera, që lidhen me interesin e qytetarëve të komunës së Prizrenit.

Të gjeturat (specifike) të monitorimit gjatë katër muajve të kaluar tregojnë se: Komuna ri-tenderon projektin që është nën hetime nga Prokuroria; kampingu në Prevallë është jashtë PRRU-së, me kontratë të skaduar dhe defekte tjera të shumta; komuna e Prizrenit ka mbyllur vitin 2012 me fatura të papaguara në vlerë prej 933 mijë eurosh, qeveria lokale duhet të gjej zgjidhje të qëndrueshme për problemin e ndriçimit publik dhe Kujdesi Parësor

Shëndetësor i Prizrenit ka shumë mangësi në organizimin e kujdestarive.

Të gjeturat sa i përket transparencës së ekzekutivit lokal të Prizrenit vërtetojnë se Transparenca në komunën e Prizrenit është ende në nivel të ulët që manifestohet me informim jo-adekuat, mos përfshirje të duhur në vendimmarrje dhe mungesë të llogaridhënies kundruall qytetarëve.

Rekomandimet e përgjithshme (transparenca):

- Zbatimi i Udhëzimit Administrativ 2008/09 i MAPL-së,
- Ekzekutivi lokal të raportoj më shpesh në media për çështjet publike,
- Kryetari, drejtorët dhe shefi i Zyrës për Informim të mbajnë konferenca periodike të shtypit
- Të amendamentohet Rregullorja për Transparencë,
- Zyra për Informim të fuqizohet me personel dhe të bëj përditësimin e ueb-faqes zyrtare të komunës.

Rekomandimet specifike (sektoriale)

- Anulimi i ri-tenderimit të projektit për rregullimin e infrastrukturës në Prevallë,
- Zbatimi i përpiktë i Planit Rregullativ për Prevallën dhe ndëshkimi i shkelësve,
- Borxhet e vitit 2012 në vlerë prej 933 mijë eurosh të paguhen në afatin sa më të shkurtër kohor,
- Komuna e Prizrenit të gjej zgjidhje të qëndrueshme për problemin e ndriçimit publik,
- Kujdestaritë në Kujdesin Parësor Shëndetësor të paguhen me rregull.

II. Degradimi i trashëgimisë natyrore

Prevalla është pjesë integrale e Parkut Nacional "Malet e Sharrit". Ky fakt nuk i ka penguar vendimmarrësit e komunës së Prizrenit dhe ata të nivelit qendror në miratimin e akteve, me të cilat është mundësuar ngritja e fshatit turistik dhe lejimi i kampingut, pa mekanizma të duhur kontrolli.

Komuna e Prizrenit bashkë me MMPH-në kanë hartuar Planin Rregullativ "Fshati turistik në Prevallë", i cili ishte miratuar nga Kuvendi Komunal i Prizrenit, më 22 qershor 2006. Ky Plan, sipas hartuesve të tij, parashihte ndërtimin e kamp shtëpizave nga druri dhe guri në mënyrë tradicionale në përshtatje të ambientit bashkë me restorantin, hapësirat rekreative, etj, të cilat është dashur të pajisen edhe me shërbimet e duhura të ujësjellësit dhe kanalizimit.

MMPH më 4 shtator 2006 pat vendosur që kompetencat e saj mbi këtë zonë t'ia bart Komunës së Prizrenit me kusht që kjo e fundit gjatë realizimit të projektit të veprjës në përputhje me Ligjin për planifikimin hapësinor, Ligjin për mbrojtjen e mjedisit dhe Ligjin për mbrojtjen e natyrës.

Gurthemeli që shënonte fillimin e ndërtimit të fshatit turistik në hapësirat e gjelbra të Prevallës ishte vënë në prill të vitit 2007 nga autoritetet lokale e qendrore të Kosovës. Asokohe fshati turistik nga ish-Presidenti Fatmir Sejdiu ishte cilësuar si projekti i parë zhvillimor i Kosovës, në sajë të cilit "bukuritë që i janë dhuruar Kosovës nga Zoti, e që vërtet janë të veçuara, po shfrytëzohen për qytetarët e saj dhe për joshjen e turistëve të huaj".¹ Ndërsa ish-ministri i MMPH-së, Ardian Gjini, sqaronte se "qëllimi i

këtij projekti është që natyra e Kosovës të vihet në shërbim të qytetarëve të saj, por në atë mënyrë që do ti shërbej edhe gjeneratave të ardhshme".²

Janë dashur vetëm pak vite që ideatorët e këtij projekti të demantohen. Vendimmarrja në favor të grupeve të interesit nga sfera e biznesit dhe politikës dhe nisja e punimeve pa mekanizma të duhur të kontrollit bashkë me hezitimin e autoriteteve lokale për të vepruar (drejtorja e Inspektoratit dhe DUPH-ja) shumë shpejtë ka zbehur ngjyrën e gjelbër të Prevallës, për t'i lënë vend betonit dhe materialit tjetër ndërtimor, në sajë të cilave janë krijuar objekte të shumta asimetrike, që kanë shkatërruar trashëgiminë që natyra e ka krijuar me shekuj. Shkeljet e Ligjit për planifikimin hapësinor, Ligjit për mbrojtjen e mjedisit dhe Ligjit për mbrojtjen e natyrës janë tashmë publike në Prevallë. Ndërkaq ata që një kohë e patën kundërshtuar realizimin e këtij projekti, e që tani dy mandate janë pushtetarë në komunën e Prizrenit, kanë vendosur që të zgjedhin rrugën më të lehtë duke u dorëzuar para këtij realiteti dhe duke mundësuar degradimin e mëtejshëm të gjelbërimit të Prevallës.

Kryetari i komunës, Ramadan Muja, me të marrë udhëheqjen e Prizrenit pat shprehur pakënaqësitë lidhur me gjendjen në Prevallë para forumeve dhe zyrtarëve të ndryshëm. Ai pat kundërshtuar këtë projekt me arsyetimin se zona rreth Prevallës është pjesë e Parkut Nacional, për të cilin ekzistojnë rregulla ndërkombëtare dhe kombëtare, që përcaktojnë se në cilën formë mund të ndërtohet fshati turistik. Komuna fillimisht kishte kërkuar që të ndërpriten ndërtimet në këtë zonë, sepse konsideronte se fshati turistik e prek një pjesë

¹ "Sejdiu: Prevalla projekti i parë zhvillimor i Kosovës", Koha Ditore, 22 prill 2007

² "Sejdiu: Prevalla projekti i parë zhvillimor i Kosovës", Koha Ditore, 22 prill 2007

të zonës e cila është nën mbrojtje absolute, si trashëgimi natyrore. Edhe institucioni i Ombudspersonit, me letrën e datës 6 qershor 2008, dërguar Kuvendit të Kosovës, ia tërheq vërejtjen Kuvendit se në parkun nacional "Malet e Sharrit" mbizotëron një gjendje e papranueshme e karakterizuar me shkatërrime ilegale të resurseve natyrore dhe shkelje të shumta ligjore.³ Mirëpo vërejtjet e dhëna nuk janë marrë parasysh dhe ndonëse problemi ishte bartur edhe në Kuvendin e Kosovës respektivisht komisionin përkatës parlamentar, asnjë vendim nuk ishte nxjerrë. Në seancën e Kuvendit të Kosovës të datës 3 tetor 2008 u zhvillua debati rreth Fshatit Turistik "Prevalla" dhe i njëjti nuk u finalizua asnjëherë.

Komisioni Parlamentar për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, pas hetimeve të bëra kishte konstatuar se në Prevallë ka shkelje të ligjeve bazike që rregullojnë çështjen e planifikimit hapësinor, parqeve nacionale dhe mbrojtjes së mjedisit. Debati në Kuvendin e Kosovës rreth kësaj çështjeje ishte mbyllur me vullnetin e partive të koalicionit qeverisës, për të mos u bërë më pjesë e rendit të ditës. Në raportin e komisionit parlamentar kërkohet që të ndërpriten të gjitha aktivitetet në zonën e parkut nacional Malet e Sharrit, veprimtaria e gurëthyesve, aktivitetet ndërtimore në fshatin turistik "Prevalla" si dhe prerjet ilegale të pyjeve, pastaj që Kuvendit të krijoj një komision hetimor për të konstatuar shkeljet dhe për të adresuar përgjegjësitë, ndërkohë që nga Qeveria dhe MMPH-ja kërkohet hartimi i planit për sanimin e gjendjes dhe hartimi i planit hapësinor për parkun nacional "Malet e

Sharrit"⁴. Por këto rekomandime nuk u miratuan nga Kuvendi i Kosovës.

Ndërkohë Komuna e Prizrenit, respektivisht DUPH-ja edhe në vitin 2010 pat vazhduar me dhënien e lejeve ndërtimore sipas Planit Rregullativ të 2006-ës. Ndonëse kishte vendosur si afat përfundimin e ndërtimeve deri në mes të vitit 2011, një gjë e tillë nuk ka ndodhur. Ndërtimet në Prevallë vazhdojnë edhe sot e kësaj dite, madje edhe pa leje të organeve komunale të Prizrenit. Krijimit të kësaj gjendjeje i ka kontribuar edhe pushteti lokal, me "tolerancën" që ka treguar në mos zbatimin e përpiktë të Planit Rregullativ dhe me mos përfilljen e vërejtjeve dhe sugjerimeve të MMPH-së dhe të Parkut Nacional "Malet e Sharrit".

Mos transparenca në vendimmarrje dhe vënia e pushtetit në krah të grupeve të caktuara të interesit, qoftë nga biznesi apo politika, në kurriz të ambientit jetësor të qytetarëve ka bërë që kjo zonë e mbrojtur natyrore të përfshihet nga një kaos urbanistik shkatërrimtar, pasojat e të cilit do të jenë afatgjate. Kjo zonë e cila dikur është vlerësuar si bukuri natyrore tani është shndërruar në një shëmti betoni dhe manual se si ushtrohet krimi urbanistik, fakt ky që konstatohet edhe nga komisionet e komunale. Madje, degradimi ka shkuar aq larg sa që as Prokuroria Themelore nuk ka mundur më të qëndroj indiferente kundruall këtyre zhvillimeve negative. Dhe ndonëse Prokuroria i ka nisur hetimet në bazë të dyshimeve për keqpërdorim të mjeteve të dedikuara për rregullimin e infrastrukturës në Prevallë⁵, autoritetet komunale të Prizrenit kanë miratuar

⁴ Transkript, Seanca Plenare e Kuvendit të Kosovës, 3 dhe 10 tetor 2008, http://www.assembly-kosova.org/common/docs/proc/trans_s_2008_10_03_10_al.pdf

⁵ Koha.net, "Prokuroria heton defektet në rregullimin e infrastrukturës në Prevallë", 25 dhjetor 2012, http://www.koha.net/arkiva/index.php?page=1,31,128796&s=prokuroria&ch=13,31,14,15,16,17&f_d=12.12.2012&t_d=26.12.2012

³ Transkript, Seanca Plenare e Kuvendit të Kosovës, 3 dhe 10 tetor 2008, http://www.assembly-kosova.org/common/docs/proc/trans_s_2008_10_03_10_al.pdf

konkluzionin për ri-tenderimin e projektit për rregullimin e infrastrukturës në fshatin turistik Prevallë⁶.

Shqetësimet në lidhje me gjendjen e krijuar në fshatin turistik të Prevallës, ku ndërtimet po vazhdojnë pa respektimin e lejeve të ndërtimit të dhëna nga DUPH-ja si dhe për ri-tenderimin e projektit që është nën hetime, janë përforcuar me raportin e shtatë drejtorive në lidhje me gjendjen në kampingun e Prevallës, ku sipas të dhënave të organeve komunale kontrata e menaxhimit të kampingut ka skaduar që nga data 15 maj 2011. Të gjeturat e komisionit përkatës komunal, që janë përshkruar në procesverbalin e hartuar pas pesë takimesh të zhvilluara në vitin 2012, dëshmojnë për gjendjen skandaloze dhe alarmante në këtë zonë⁷. *(Të gjeturat e hollësishme të monitorimit në lidhje me Prevallën mund ti gjeni në faqen 10 të raportit).*

III. Degradimi urbanistik brenda qytetit

Zhvillimet në Prevallë janë vetëm vazhdimësi e trendëve urbanistike brenda qytetit të Prizrenit, në këto 14 vitet e fundit. Ndërtimet pa leje, përshtatja e Planeve Rregullative Urbane nevojave të grupeve të interesit që merren me biznesin e ndërtimitarisë dhe mos krijimi i mekanizmave të kontrollit bashkë me mos veprimin e duhur institucional, duke nisur nga DUPH-ha, Inspektorati e deri te organet e drejtësisë kanë bërë që Prizreni të përfytyroj një degradim të pariparueshëm urbanistik, duke rrezikuar madje edhe bërthamën qendrore të Zonës Historike.

Monitorimi i punës së ekzekutivit komunal nga EC Ma Ndryshe ka nxjerrë në pah faktin se mos respektimi i kriterëve të ndërtimit nuk ndëshkohet nga institucionet, ndërkohë që gjendja e krijuar në fushën e urbanizmit dhe planifikimit hapësinor është alarmante pasi që ndërtimet vazhdojnë me shpërfillje të lejeve të ndërtimit të dhëna nga DUPH-ja. Këtë trend e kanë konfirmuar rastet konkrete, që janë hulumtuar, si kompleksi afarist-banesor “Euro-Center” që është ndërtuar në Zonën e Mbrojtur të Qendrës Historike të Prizrenit⁸. DUPH dhe Inspektorati (ekzekutivi komunal) janë treguar tolerant ndaj këtij investitori duke i mundësuar ndërtim më etazhitet më të lartë, pa leje përkatëse. Pas ndërtimit tanimë të përfunduar të këtij objekti, ky investitor, nuk është ndalur më kaq duke filluar edhe aneksin tjetër po ashtu pranë këtij objekti pa kurrfarë kriteri. Një objekt tjetër që ka qenë në ndërtim e sipër dhe për të cilin “EC Ma Ndryshe” ka kërkuar veprime konkrete parandaluese nga përgjegjësit tanimë është në përfundim të punimeve. Për tejkalimet në ndërtimin e këtij objekti hotelier pranë shtëpisë së Shuaip Spahisë, IMMK-ja pat alarmuar Drejtorinë e Inspektoratëve të komunës së Prizrenit. Sipas aktvendimit të Drejtorisë së Inspektoratëve, investitori nuk i është përmbajtur lejes urbanistike “dhe ka bërë tejkalim në gabarit dhe etazhitet të objektit”⁹. Me këtë aktvendim DI-ja ka urdhëruar investuesin e punimeve që në afatin prej 7 ditësh të bëj rrënimin e pjesës shtesë në gabarit dhe etazhitet. Për këtë rast kanë reaguar edhe institucionet tjera si, Këshilli i Bashkësisë Islame në Prizren¹⁰, ndërsa DI-ja ka parashtruar një kërkesë pranë Gjykatës për Kundërvajtje për

⁶ Njoftim, EC Ma Ndryshe, “Ri-tenderohet projekti i rregullimit të infrastrukturës në Prevallë, 25.10.2012, <http://www.online-transparency.org/?page=1,42,25>

⁷ Procesverbali për Kampingun në Prevallë, i hartuar nga Komisioni i formuar me aktvendimin e Kryetarit të Komunës me nr. 01/06-11514

⁸ Komunikatë e EC Ma Ndryshe, “Mos respektimi i kriterëve të ndërtimit të ndëshkohet nga institucionet”, 14 shtator 2012, http://www.online-transparency.org/repository/docs/Komunikate_14_shtator.pdf

⁹ Aktvendim i Inspektoratit të Ndërtimitarisë, Drejtoria e Inspektoratëve, komuna Prizren, më 7.09.2012

¹⁰ Shkresa e KBI Prizren për KK, DI, MKRS, IMMh për inspektimin e punimeve pranë xhamisë së Sejdi Beut, më 10.09.2012

fillimin e procedurës kundërvajtës, me arsyetimin se investuesi nuk e ka respektuar lejen e ndërtimit të lëshuar nga DUPH-ja¹¹.

Monitorimi i ekzekutivit lokal pat vërtetuar se rreth 80 për qind e ndërtimeve në qytetin e Prizrenit nuk i përmbahen lejeve të ndërtimit, që bashkë me shprehjen e tendencës për pazarllëqe të ndryshme me kompanitë ndërtimore janë fenomeni dominues i projekteve urbanistike të financuara nga buxheti i komunës së Prizrenit¹².

Dëshmia më e mirë për degradimin urbanistik të Prizrenit është shkresa zyrtare e Drejtorisë së Urbanizmit drejtuar Drejtorisë së Inspektoratit, në të cilin, në mes tjerash thuhet se “në bazë të evidencës që posedon shërbimi i DUPH ju njoftojmë se ndërtimet të cilat janë duke u zhvilluar kohëve të fundit janë mjaft shqetësuese; ato të cilat kanë leje ndërtimi mbi 80% nuk i janë përmbajtur lejes së ndërtimit ndërsa një numër shumë i madh i ndërtimeve tjera janë pa kurrfarë leje të ndërtimit. Shërbimi i DUPH-së është i shqetësuar sidomos në lokacionet për të cilat disponon me plane rregulluese (Prevallë, Jani Mëhallë, Lakuriqi, Dardania etj) ndërsa në brendinë e tyre ndërtohet duke mos ju përmbajtur planeve rregulluese”¹³.

Në lidhje me degradimin urban të qytetit, EC Ma Ndryshe ka paraqitur edhe raste konkrete si kontribut shtesë në përpjekjet për të sjellë rend urbanistik në Prizren. Ngjashëm rastet e tilla janë identifikuar edhe në Qendrën Historike të Prizrenit. Mirëpo ato nuk kanë mjaftuar që të

sensibilizojnë në masën e duhur zyrtarët vendimmarrës të qeverisë komunale të Prizrenit, të cilët kanë vazhduar me dhënien e lejeve dhe mos ndëshkimin e tejkalimeve, apo edhe kanë mbyllur sytë në rastet kur ndërtimet janë zhvilluar pa leje përkatëse ndërtimore.

Në shkurt të këtij viti monitoruesit kanë raportuar se qeveria komunale e Prizrenit me kërkesën e Drejtorisë së Inspektorateve, ka nxjerrë konkluzionin për lejimin e shpalljes së tenderit për përzgjedhjen e operatorit ekonomik që do të merret me ekzekutimin e ndërtimeve pa leje në territorin e komunës së Prizrenit. Periudha e zbatimit përfshin afatin një vjeçar, pra vitin 2013, me ç’rast paralogaria e DI-së për ekzekutimin e objekteve pa leje kap shumë prej 50 mijë eurosh. Rezultatet e pritura nga zbatimi i këtij vendimi në bazë të propozimit të DI-së janë: respektimi i zbatimit të planeve urbanistike, realizimi i ndërtimeve sipas standardeve dhe rritja e buxhetit komunal.

Mirëpo bazuar në raportin vjetor të Drejtorisë së Inspektorateve, gjatë vitit 2012, Inspektorati i Ndërtimtarisë ka realizuar ekzekutime vetëm në shtatë raste, ndërkohë që numri i kërkesave për kundërvajtje është dhjetëfish më i madh¹⁴. Ndërkohë DI përmes një shkrese ka njoftuar monitoruesit se është në pritje të aprovimit të Ligjit për Legalizimin e Ndërtimeve pa leje dhe se vetëm më pas do të merren veprime përkatëse¹⁵. Që ironia të jetë edhe më e madhe, vetë KK-ja e Prizrenit ka miratuar rregulloren për trajtimin e ndërtimeve pa leje pa pasur bazë të duhur ligjore për këtë dhe përkundër sqarimeve të MAPL-së dhe MMPH-së nuk e ka anuluar atë¹⁶.

¹¹ Kërkesa e DI-së për fillimin e procedurës kundërvajtëse kundër investuesit Minire Hoti pranë Gjykatës për Kundërvajtje në Prizren, më 12.09.2012

¹² Komunikatë e EC Ma Ndryshe, "Deurbanizimi i Qendrës Historike të Prizrenit", 27 qershor 2012, http://www.online-transparency.org/repository/docs/Komunikate_4.pdf

¹³ Shkresa zyrtare Nr. 04-353 e Drejtorisë së Urbanizmit drejtuar Drejtorisë së Inspektorateve të komunës së Prizrenit

¹⁴ Raporti Vjetor i DI-së, komuna Prizren, 01.01.2012 – 31.12.2012

¹⁵ Përgjigje e DI-së në kërkesën e EC Ma Ndryshe, më 14.03.2013

¹⁶ Reagim i përbashkët EC Ma Ndryshe dhe KDI, http://www.online-transparency.org/repository/docs/EC_KDI_Reagim.pdf

IV. Konstatime të përgjithshme mbi transparencën

Transparenca nuk duhet të jetë një çështje e diskutueshme, sepse transparenca dhe llogaridhënia përbëjnë hapin e parë drejt qeverisjes së mirë dhe efektive. Transparenca e duhur rreth vendimmarrjes sjell dobi si për komunitetin ashtu edhe për udhëheqësit komunal. Të qenit të informuar rreth projekteve komunale ndihmon qytetarët që të identifikohen dhe të lidhen me komunitetin. Një lidhje e tillë është jetike për qeverinë lokale që të funksionojë në mënyrë efektive dhe të marrë vendime në interes të publikut. Përveç kësaj, shpërndarja e informatave përbën një parakusht të rëndësishëm, për adresimin e prioriteteve të qytetarëve, planifikimin e duhur hapësinor dhe hartimin e buxhetit racional.

Gjatë periudhës raportuese monitoruesit e EC Ma Ndryshe janë përballur disa herë me vonesa në sigurimin e dokumenteve zyrtare në lidhje me çështjet e hulumtuara. Përpos vonesave, e pranishme ka qenë edhe dukuria e ofrimit të informatave gjysmake nga ana e dikastereve të qeverisë komunale, që kanë pamundësuar ofrimin e qëndrimit të qartë në lidhje me temën e hulumtuar. Gjatë hulumtimit disa javor në lidhje me Prevallën, EC Ma Ndryshe ka konstatuar parregullsi të shumta të Qeverisë komunale në raport me transparencën në zbatimin e projektit për rregullimin e infrastrukturës në Prevallë. Me javë të tëra monitoruesit e EC Ma Ndryshe kanë tentuar që të sigurojnë kontratën dhe dosjen përcjellëse të projektit “Ndërtimi me koncesion i infrastrukturës në fshatin turistik Prevallë”.

Në bazë të Memorandumit të Bashkëpunimit të nënshkruar me komunën e Prizrenit, EC Ma

Ndryshe ka kërkuar nga DUPH-ja që të lejoj qasjen në dokumentet zyrtare, respektivisht kontratën dhe dosjen përcjellëse të projektit “Ndërtimi me koncesion i infrastrukturës në fshatin turistik Prevallë”. Përkundër pritjes disa ditore nuk është marrë ndonjë përgjigje nga DUPH-ja. Atëherë EC Ma Ndryshe ka dorëzuar kërkesën e njëjtë edhe në Zyrën për Informim të komunës së Prizrenit. ZI-ja ka bërë përpjekje për të ndihmuar monitoruesit e EC Ma Ndryshe duke propozuar kërkimin e kontratës edhe në Zyrën e Prokurimit. EC Ma Ndryshe ia ka adresuar një kërkesë edhe kësaj Zyreje dhe përgjigja që ka marrë nga zyrtarët ka qenë “se e tërë dosja për rregullimin e infrastrukturës në Prevallë është në hetuesi, meqë kjo kontratë është duke u hetuar nga Policia”.

Pas gjithë këtyre kërkesave, EC Ma Ndryshe ka pranuar një njoftim të shkurtër nga DUPH-ja në lidhje me kërkesën për qasjen në dokumentet publike. Në këtë shkresë DUPH-ja bën të ditur se “KK Prizrenit implementon këtë projekt sipas participimit të pronarëve gjatë marrjes së lejeve ndërtimore” dhe se një operator privat ekonomik i ka realizuar punimet sipas kontratës përkatëse derisa “KK Prizrenit nuk e financon këtë projekt”¹⁷. Po ashtu bëhet e ditur se “projekti është ende në fazën e implementimit”. Për shkak të mungesës së kontratës dhe dosjes në përgjithësi, sikurse edhe paqartësive të shumta sa i përket mënyrës së zbatimit të këtij projekti, EC Ma Ndryshe e ka pas të pamundur që të nxjerr një konstatim të qartë mbi rrjedhën e zhvillimeve në këtë projekt. Në të njëjtën kohë mungesa e transparencës ka bërë që të ngriten edhe dyshime mbi rregullsinë e kontraktimit dhe zbatimit të projektit, të cilat duhet të zbardhen deri në fund nga organet e drejtësisë.

¹⁷ Përgjigje me shkrim e DUPH-së në kërkesën e EC Ma Ndryshe për qasje në dokumentet publike, më 7.12.2012

Që prej fillimit të monitorimit, EC Ma Ndryshe shpesh herë ka theksuar se transparencja e komunës ka të meta strukturore dhe se përkundër përpjekjeve modeste të liderit komunal vazhdon të jetë në nivel të ultë, që manifestohet me informim jo-adekuat, mos përfshirje të duhur në vendimmarrje dhe mungesë të llogaridhënies kundruall qytetarëve. Për t'i mbështetur këto konstatime, EC Ma Ndryshe gjatë periudhës raportuese ka analizuar raste specifike që çojnë deri te përfundimi se ekzekutivi lokal duhet të bëjë përpjekje të shumta dhe të sinqerta që të përmirësojë transparencën dhe komunikimin me qytetarët, ndaj të cilëve edhe ka përgjegjësi.

Pas kërkesave të shumta EC Ma Ndryshe ka siguruar raportin e hulumtimit të bërë nga MPR Consulting mbi "Përmirësimin e shërbimeve komunale, përgjegjshmërisë dhe zhvillimit të ekonomisë lokale". Në bazë të tenderit të shpallur në shtator të vitit të kaluar nga komuna qëllimi i këtij hulumtimi ka qenë identifikimi i problemeve dhe mundësive të përmirësimit të të hyrave vetanake të komunës së Prizrenit. Mirëpo edhe pse hulumtimi është kryer në nëntor të vitit të kaluar dhe ka pas për synim përmirësimin e arkëtimit të hyrave vetanake, komuna e Prizrenit respektivisht Drejtoria për Ekonomi dhe Financa nuk i ka bërë publike të gjeturat e hulumtimit. Në bazë të faturës së MPR Consulting, DEF për këtë hulumtim ka paguar 9 mijë e 950 euro.

Për EC Ma Ndryshe ka qenë e papranueshme qasja e zyrtarëve komunal që t'i mbajnë të fshehura rezultatet e hulumtimit edhe pse projekti është paguar nga mjetet e taksapaguesve prizrenas. Çështja bëhet edhe me serioze kur dihet se projekti është hartuar me qëllim të rritjes së arkëtimit të të hyrave vetanake, ndërkohë që bizneset nuk janë

njoftuar me përmbajtjen e hulumtimit. Po ashtu në hulumtim theksohet se "sa i përket transparencës në përgjithësi qytetarët nuk janë mirë të informuar rreth transparencës së administratës lokale."

Një çështje tjetër e cila duhet të respektojë parimet e vendimmarrjes transparente është ajo e ndërtimit të impiantit të ujërave të zeza. Në mars të vitit 2012, KK-ja e ka autorizuar kryetarin Ramadan Muja që të marrë kredi apo hua në vlerë prej tre milionë eurosh, me qëllim të shpronësimit të parcelave private në fshatin Vlashnje, ku parashihet realizimi i këtij projekti¹⁸. Në raportin e punës për vitin 2012 kryetari Muja nuk ka dhënë asnjë informatë mbi rrjedhën e kredi apo hua marrjes. Raportim të tillë nuk ka bërë as para anëtarëve të KK-së, nga të cilët e ka marrë këtë autorizim.

Ndërkaq gjatë monitorimit përgjatë disa muajve, EC Ma Ndryshe ka vërejtur edhe rrjedhën e ngadaltë të informatave dhe dokumenteve nga të gjitha drejtoritë të Zyra për Informim dhe Komunikim, gjë që sjell deri te mos publikimi i vendimeve në kohë reale dhe mos informimi i duhur i publikut për vendimmarrjen lokale. Kjo dukuri bën që edhe transparencja online komunës të ketë defekte serioze, që nuk përkon me zotimet për qeverisje llogaridhënëse. Duke i marrë për bazë të gjitha këto të dhëna, EC Ma Ndryshe konstaton se transparencja në komunën e Prizrenit mbetet në nivel jo të kënaqshëm. Kryetari i komunës dhe ekzekutivi lokal duhet të shtojnë përpjekjet që të njoftojnë me kohë publikun mbi vendimet, planet, projektet, buxhetin, hulumtimet dhe çështjet tjera me rëndësi për publikun.

¹⁸ KK Prizren, Vendim për lejimin e huamarrjes (kredisë) me qëllim të realizimit të projektit të ndërtimit të ujërave të zeza të qytetit të Prizrenit, më 8 mars 2012, <http://kk.rks-gov.net/prizren/getattachment/8e8d0f01-7f38-4546-bc16-fa075bec616e/Vendimet-e-dates-08-03-2012.aspx>

V. Të gjeturat specifike të monitorimit

Gjatë periudhës raportuese monitoruesit e transparencës së qeverisë komunale janë përqendruar në hulumtimin e disa çështjeve të ndryshme, që lidhen me mbrojtjen e interesit të qytetarëve të komunës së Prizrenit. Të gjeturat specifike të monitorimit gjatë katër muajve të kaluar lidhen me vendimmarrjen lokale në sferat e urbanizimit, financave publike, shërbimeve publike dhe kujdesit primar shëndetësor dhe janë të paraqitura në vijim:

Komuna ri-tenderon projektin që është nën hetime – Gjatë hulumtimit disa javor, EC Ma Ndryshe ka konstatuar parregullsi të shumta të Qeverisë komunale në raport me transparencën në zbatimin e projektit për rregullimin e infrastrukturës në Prevallë. Në muajin tetor kryetari i komunës, Ramadan Muja në takimin e rregullt me drejtorët komunal ka miratuar konkluzionin për ri-tenderimin e projektit për rregullimin e infrastrukturës në fshatin turistik Prevallë. Bazuar në shkresën e DUPH-së të prezantuar në këtë takim thuhet se “komuna në vitin 2007 ka lidhur kontratë me një operator ekonomik për rregullimin e infrastrukturës në fshatin turistik Prevallë, me çmimin prej 1.2 milionë euro, por që kjo kontratë sipas kushteve të specifikuara nuk ka mundur që të zbatohet, dhe për këtë arsye është vazhduar në vitin 2009, për afatin prej 24 muajsh, pa të drejtë të përsëritjes-vazhdimit të saj”. Aty sqarohet se DUPH-ja ka kërkuar ri-tenderimin e projektit, me qëllim të menaxhimit të PRrU-së dhe zgjidhjen e problemit të ndërtimit të vikend shtëpizave. Mirëpo tenderi ka shkuar në rishpallje, ndërkohë që Prokuroria e Qarkut në Prizren ka nisur hetimet në bazë të dyshimeve për keqpërdorim të mjeteve të dedikuara për rregullimin e infrastrukturës në Prevallë. Për shkak të mungesës së kontratës dhe dosjes në

përgjithësi, sikurse edhe paqartësive të shumta sa i përket mënyrës së zbatimit të këtij projekti, EC Ma Ndryshe e ka pas të pamundur që të nxjerr një konstatim të qartë mbi rrjedhën e zhvillimeve në këtë projekt. Po ashtu ka shprehur dyshime mbi rregullsinë e kontraktimit dhe zbatimit të projektit, të cilat duhet të zbardhen deri në fund nga organet e drejtësisë¹⁹.

Kampingu në Prevallë me defekte të shumta – Pas ngritjes së shqetësimeve në muajin dhjetor për gjendjen e krijuar në fshatin turistik të Prevallës, ku ndërtimet po vazhdojnë pa respektimin e lejeve të ndërtimit të dhëna nga DUPH-ja, dhe ri-tenderimin e projektit që është nën hetime, situatë po aq kritike përshkruhet të jetë edhe në kampingun e Prevallës, ku sipas të dhënave të organeve komunale të Prizrenit kontrata e menaxhimit të kampingut ka skaduar që nga data 15 maj 2011. EC Ma Ndryshe gjatë periudhës raportuese ka siguruar “Procesverbalin për Kampingun në Prevallë” të hartuar nga komisioni shtatë anëtarësh komunal i formuar me aktvendimin e kryetarit të komunës, Ramadan Muja. Të gjeturat e komisionit, që janë përshkruar në procesverbalin e hartuar pas pesë takimesh, dëshmojnë për gjendjen skandaloze dhe alarmante në këtë kamping. Gjatë vizitave në terren, komisioni komunal ka vërejtur defekte të shumta, si në vijim: 1. Tejkallimet në natyrën e objekteve për kampingje të përkohshme; 2. Tejkallimet në numrin e objekteve të planifikuara; 3. Materialet ndërtimore të përdorura jashtë standardeve për kampingje të përkohshme; 4. Tejkallimet në gabarit dhe në etazhitet në objektet e ndërtuara; 5. Sistemi i rrymës dhe shpërndarja e saj nëpër kamp jashtë normave, që paraqet rrezik permanent për

¹⁹ Komunikatë, EC Ma Ndryshe, 26 dhjetor 2012, http://www.online-transparency.org/repository/docs/Komunikata_dhjetor_f.pdf

banorët e kampingut; 6. Sistemi i ujësjellësit dhe kanalizimit jashtë kushteve minimale higjienë-sanitare dhe nuk plotëson asnjë kriter për shfrytëzim dhe përdorim; 7. Infrastruktura rrugore brenda dhe jashtë kampingut e papërfunduar; 8. Restoranti me përmasa dhe shtrirje shumë e madhe për nevojat e banorëve të kampingut. Komisioni i përbërë nga anëtarët e shtatë drejtorive, duke analizuar Planin Rregullativ të Prevallës ka konstatuar se kampingu në Prevallë nuk ekziston dhe ka rekomanduar se i njëjti duhet të mbyllet dhe të kthehet në gjendjen e mëparshme. Komisioni po ashtu ka theksuar se duke i marrë parasysh sugjerimet e MMPH-së dhe të Parkut Nacional “Malet e Sharrit”, kjo zonë është e veçantë dhe aty nuk lejohen ndërhyrjet në degradimin e mëtutjeshëm. Komisioni ka argumentuar se mbrojtja e kësaj zone është e rregulluar me ligjet në fuqi dhe se nuk mund të merret asnjë veprim tjetër²⁰.

Komuna mbyll vitin 2012 me fatura të papaguara në vlerë prej 933 mijë eurosh – Në bazë të Raportit Vjetor Financiar për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2012, EC Ma Ndryshe ka hasur në disa të dhëna që paraqesin shqetësime serioze sa i përket mënyrës së menaxhimit të parasë publike nga ana e qeverisë komunale. Analiza e thjeshtë e këtij raporti tregon se komuna e Prizrenit vazhdon që të operoj me shuma të mëdha të faturave të papaguara. Neni 15 i Raportit Vjetor Financiar 2012 shpalos detyrimet e komunës së Prizrenit. Në shënimin nr. 28 jepet pasqyra e faturave (obligimeve) të papaguara, që në total arrin shifrën prej 933 mijë eurosh. Vlera më e madhe e faturave të papaguara është në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve me 450 mijë euro, pastaj vijnë: pagat me 180 mijë euro, shërbimet

komunale me 123 mijë euro, investimet kapitale me 101 mijë euro dhe subvencionet me 79 mijë euro. (Detajet tjera në lidhje me faturat e papaguara nuk i janë dorëzuar EC Ma Ndryshes, edhe pse ato janë përgatitur si aneks i RVF-së nga ana e DEF-it). Ndërkaq shënimin nr. 29 në këtë nen tregon se detyrimet e komunës së Prizrenit mund të jenë edhe më të mëdha. Detyrimet kontingjente që mund të prekin buxhetin komunal kapin vlerën prej 1 milionë e 743 mijë eurove, e që përfshijnë kompensime të ndryshme, pagesën e të ardhurave personale, borxheve e pretendimeve tjera. Shuma e detyrimeve të komunës së Prizrenit është e madhe, ndërkohë që ka pas rënie të dukshme të investimeve kapitale. Derisa në vitin 2011 janë shpenzuar 14 milionë e 494 mijë euro për investime kapitale në vitin 2012 janë shpenzuar 12 milionë e 182 mijë euro ose 2.3 milionë euro më pak investime kapitale²¹.

Probleme të theksuara me ndriçimin publik – EC Ma Ndryshe gjatë periudhës raportuese ka pranuar ankesa nga qytetarët në lidhje me shërbimet elementare komunale, përkatësisht mungesën e ndriçimit publik. Banorë të rrugës së Ulqinit janë ankuar se ndriçimi publik në rrugët e kësaj lagjeje ka një vit që nuk funksionon. Shqetësimi i tyre lidhet me nevojën që nxënësit duhet të lëvizin patjetër në këto rrugë, në orët e mbrëmjes, ngase atëherë kthehen nga shkolla. Sipas tyre ekziston rreziku potencial që këta fëmijë të pësojnë nga automjetet që qarkullojnë në këtë pjesë të qytetit, ku nuk funksionojnë dritat publike. Ndërsa përfaqësuesit e komunitetit të grave, të moshuarve dhe të rinjve e kanë paraqitur si shqetësim serioz mos funksionimin e duhur të ndriçimit publik, në lagjet e qytetit dhe ato periferike. Ata druajnë se kjo gjendje ka ndikim

²⁰ Komunikatë, EC Ma Ndryshe, 22 janar 2013, http://www.online-transparency.org/repository/docs/Komunikate_janar_2013.pdf

²¹ Komunikatë, EC Ma Ndryshe, 20 shkurt 2013, http://www.online-transparency.org/repository/docs/Komunikate_shkurt_20.pdf

edhe në sigurinë e përgjithshme. Lagjet që përballen me këtë problem sipas këtyre grupeve janë “Bajram Curri”, “4 Kullat” në Bazhdaranë, “Ortakolli 2”, “Petrova”, dhe lagje të tjera. Në bazë të Raportit Vjetor Financiar për vitin 2012, komuna e Prizrenit ka borxhe të papaguara për shërbimet komunale. Në pasqyrën e faturave (obligimeve) të papaguara të komunës së Prizrenit thuhet se shifra e borxhit është 123 mijë euro. Në këtë raport bëhet e ditur se për shërbimet komunale në vitin 2012 janë shpenzuar 803 mijë euro, respektivisht 519 mijë euro për rrymë, që është shumë më e madhe se shpenzimet e rrymës në vitin 2011 që kanë qenë 399 mijë euro dhe në vitin 2010, 375 mijë euro²².

Kujdesi Parësor Shëndetësor i Prizrenit me shumë mangësi në organizimin e kujdestarive – Hulumtimi disa javor i çështjes së pagesës së kujdestarive në Kujdesin Parësor Shëndetësor të Komunës së Prizrenit ka nxjerrë në pah faktin se ndonëse gjatë vitit 2012 janë grumbulluar mjete të konsiderueshme nga bashkë pagesat e pacientëve, ato nuk kanë mjaftuar për të mbuluar kujdestaritë respektivisht për të kryer obligimet ndaj personelit mjekësor, që janë të angazhuar në Kujdesin Parësor Shëndetësor, edhe pse një gjë e tillë garantohet me Kontratën Kolektive Sektoriale. Një gjë e tillë ka bërë që disa Qendra të Mjekësisë Familjare prej disa muajsh të jenë të mbyllura gjatë ditëve të vikendit. Të dhënat e Drejtorisë Komunale për Shëndetësi tregojnë se në vitin 2012 nga bashkë pagesat janë grumbulluar rreth 196 mijë euro derisa afër 30 mijë euro janë bartur nga viti 2011, që në total bëjnë 225 mijë euro. Nga këto mjete mbi 90 mijë euro janë ndarë për pagesën e kujdestarive derisa rreth 88 mijë euro janë shpenzuar për pagat e punonjësve shëndetësor

të nivelit primar. “Me këto mjete të bashkë pagesave e kemi plotësuar “minusin” në pozicionin e pagave të punëtorëve. Ky “minus” në paga për vitin 2012 ka qenë si pasojë e gabimit në planifikim të pagave për vitin 2012, nga Ministria e Financave”, thuhet në përgjigjen e DKSH-së, drejtuar “EC Ma Ndryshes”, ku potencohet se borxhi i mbetur për kujdestari për vitin 2012 është 35 mijë euro. Gjatë kësaj periudhe “EC Ma Ndryshe” ka intervistuar edhe punonjës shëndetësor të nivelit parësor, të cilët kanë shprehur pakënaqësi në lidhje me mos pagesën e kujdestarive nga shtatori i vitit të kaluar e deri në janar të këtij viti, ndërkohë që ka vonesa edhe nga 6 muaj në pagesat e kujdestarive të mëhershme. Sipas tyre kujdestaritë që nga pas luftime janë paguar me rregull, deri në shtator të 2012-ës, kur është ndërprerë kjo praktikë, që për pasojë ka sjellë edhe mbylljen e QMF-1, QMF-2 dhe QMF-3 në fundjava. Ata kanë shpjeguar se rikthimi i pagesave nga shkurti, ka bërë që vetëm QMF-1 të kthehet në funksion gjatë vikendeve, derisa QMF-2 dhe QMF-3 ende nuk punojnë. Këto pretendime janë konfirmuar nga krerët e Kujdesit Primar Shëndetësor, drejtori i DKSH-së, Nexhip Berisha dhe drejtori i QKMF-së, Mehmedali Gashi. Në një reagim publik ata kanë pranuar se: “Që nga shtatori i vitit të kaluar kujdestaritë gjatë vikendeve u reduktuan në disa QMF për shkak të pamundësisë së pagesës së tyre. Kujdestaritë paguhen ekskluzivisht nga të hyrat e bashkë pagesave”²³.

²² Komunikatë, EC Ma Ndryshe, 8 mars, http://www.online-transparency.org/repository/docs/Komunikate-Ndriqimi_Publik.pdf

²³ Komunikatë, EC Ma Ndryshe, 20 mars, <http://www.online-transparency.org/repository/docs/Komunikate-kujdestarite.pdf>

VI. Rekomandime

Rekomandime të përgjithshme (transparenca)

Për të adresuar të metat e përgjithshme sa i përket transparencës së qeverisë komunale rekomandojmë që:

- Qeveria Komunale të zbatoj në përpikëri dispozitat e Udhëzimit Administrativ 2008/09 të MAPL-së për transparencë,
- Ekzekutivi lokal të raportoj më shpesh në media për çështjet që lidhen me përdorimin e buxhetit komunal, zhvillimin ekonomik, përdorimin e pronës komunale, planifikimin urban, investimet, të hyrat komunale dhe çështje tjera,
- Kryetari, drejtorët dhe shefi i Zyrës për Informim të mbajnë konferenca periodike të shtypit, por edhe të organizojnë seanca të pyetje-përgjigjeve me publikun e gjerë ose grupet e interesit,
- Të amendamentohet Rregullorja për Transparencë dhe të përfshihen në mënyrë eksplicite obligimet e kryetarit dhe ekzekutivit komunal në raport me transparencën lokale,
- Zyra për Informim të fuqizohet me personel dhe të bëj përditësimin e ueb-faqes zyrtare të komunës me informacione relevante për qytetarët e komunës së Prizrenit.

Rekomandime specifike (sektoriale)

Në bazë të të gjeturave të deritanishme në sektorët specifik të qeverisjes lokale, EC Ma Ndryshe rekomandon ndërmarrjen e një numri veprimesh për të përmirësuar praktikën e veprimit, vendimmarrjes dhe zbatimit të projekteve nga qeveria lokale:

- *Anulimi i ri-tenderimit të projektit për rregullimin e infrastrukturës në Prevallë* – Kryetari i komunës së Prizrenit të anuloi ri-tenderimin e këtij projekti përderisa hetuesit të kryejnë punën e tyre dhe

gjyqësori të jep verdiktin e vet final. Po ashtu, vendimi i Prokurorisë për iniciimin e hetimeve dhe zbardhjen e të gjitha paqartësive në këtë projekt është i mirëseardhur për interesin publik. Ekzekutivi komunal të shqyrtoj praktikën e deritanishme të transparencës dhe të siguroj qasje të plotë dhe të papenguar të dokumentet publike, sidomos tek ato që implikojnë financa të konsiderueshme. Qeveria e Prizrenit rekomandohet që urgjentisht të ndërmarrë veprime të nevojshme për rehabilitimin e gjendjes në fshatin turistik të Prevallës. MMPH-ja të angazhohet në këtë drejtim dhe të mbikëqyr nga afër aktet dhe projektet që miratohen nga komuna e Prizrenit, me qëllim të parandalimit të degradimit të mëtejshëm të Prevallës, si pjesë e Parkut Nacional Malet e Sharrit,

- *Zbatimi i përpiktë i Planit Rregullativ për Prevallën dhe ndëshkimi i shkelësve* – Kryetari i komunës, drejtorja e DUPH-së dhe KK-ja të ndërmarrin veprime energjike dhe të menjëhershme për mbrojtjen e kësaj zone nga degradimi i mëtutjeshëm; Kryetari i Komunës të dëshmoj lidership duke u vënë në krye të nismës për ndalimin e shkatërrimit të kësaj trashëgimie natyrore, nga ndërtimet e shumta pa leje dhe kampingu skandaloz; MMPH-ja si bashkë-hartuese e Planit Rregullativ për Prevallën ka përgjegjësi për zbatimin e përpiktë të tij dhe duhet të ndaloj masakrën urbane e mjedisore në Prevallë; organet e drejtësisë të vazhdojnë si dhe të zgjerojnë hetimet e nisura në lidhje me dyshimet për shkeljet ligjore në fshatin turistik Prevallë, në mënyrë që çdo veprim jashtëligjor të adresohet në gjyqësor,
- *Borxhet e vitit 2012 në vlerë prej 933 mijë eurosh të paguhen në afatin sa më të*

shkurtër kohor – Kryetari i Komunës së Prizrenit të jetë i kujdesshëm në shpenzimin e parasë publike, pasi që ai ka obligim ligjor dhe moral që të menaxhojë me përgjegjësi paratë e taksapaguesve të Prizrenit; Në marrjen e vendimeve buxhetore, kryetari i Komunës duhet t'i ketë parasysh standardet e qeverisjes së mirë, të menaxhimit adekuat me paranë publike si dhe nivelin socio-ekonomik të qytetarëve në përgjithësi; Edhe anëtarët e Kuvendit të Komunës të ushtrjnë në mënyrë më efikase rolin e mbikëqyrësit të ekzekutivit, sidomos kur bëhet fjalë për buxhetin komunal dhe mënyrën e realizimit të tij,

- *Komuna e Prizrenit të gjej zgjidhje të qëndrueshme për problemin e ndriçimit publik* – Ekzekutivi komunal në afatin sa më të shkurtër t'i kryej obligimet që ka ndaj Korporatës Energjetike të Kosovës, në mënyrë që të kthehet ndriçimi publik në të gjitha rrugët e Prizrenit; Qeveria komunale dhe në veçanti Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave dhe Komiteti për Politikë e Financa gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit apo rishikimit të buxhetit të kenë kujdes në planifikimin e linjave buxhetore dedikuar për shpenzimet komunale, në mënyrë që të gjendet një zgjidhje e qëndrueshme për çështjen e ndriçimit publik; Policia e Kosovës të merr parasysh shqetësimet e qytetarëve dhe të rris patrullimet në rrugët e qytetit, ku përkohësisht nuk funksionon ndriçimi publik,
- *Kujdestaritë në Kujdesin Parësor Shëndetësor të paguhen me rregull* – Qeveria lokale në afatin sa më të shkurtër duhet t'i qartësoj mosmarrëveshjet apo gabimet me Ministrinë e Financave, në mënyrë që të ketë planifikim të duhur të pagave por edhe të kujdestarive, me qëllim

që qytetarët e Prizrenit të kenë shërbime të duhura mjekësore gjatë 24 orëve; Drejtuesit e QKMF-së dhe të DKSH-së por edhe niveli qendror të jenë më të kujdesshëm në zbatimin e përgjegjësive të tyre institucionale, që të mos përsëriten situatat kur për shkak të gabimeve të tyre e pësojnë qytetarët dhe sakrifkohet shërbimi mjekësor 24 orësh; Anëtarët e Kuvendit Komunal të Prizrenit të jenë më aktiv në adresimin e problemeve të përditshme të qytetarëve por edhe në mbikëqyrjen e punës dhe financave të ekzekutivit komunal.

VII. Aktivitetet/raportimi

Në periudhën raportuese të projektit EC Ma Ndryshe ka ndërmarrë aktivitete të monitorimit duke përfshirë edhe avokimin dhe adresimin e shkeljeve ligjore të komunës së Prizrenit. Monitorimi ka qenë i përqendruar në degët e ekzekutivit të komunës (kryetari i komunës dhe drejtoritë) si dhe shërbimi civil. Monitorimi është kryer përmes monitoruesve permanentë, të cilët kanë pas prezencë të rregullt në mbledhjet e qeverisë lokale, zyrat komunale dhe qasje në dokumentet zyrtare të komunës.

Të gjeturat e monitorimit janë postuar në ueb-faqen e projektit, www.online-transparency.org. Ueb-faqja është përkthyer edhe në gjuhën angleze dhe përditësimi i përmbajtjes në të dyja gjuhët bëhet në kohë reale. Po ashtu janë lëshuar komunikatat e rregullta (dy-javore) për media, me informata përmbledhëse të të gjeturave të monitorimit.

Gjatë kësaj periudhe kryetari i komunës së Prizrenit ka mbajtur të hapura mbledhjet e qeverisë komunale për monitoruesit e EC Ma Ndryshe. Me qëllim të informimit të publikut

me vendimet e marra EC Ma Ndryshe ka publikuar njoftime përkatëse rreth vendimeve të qeverisë lokale të Prizrenit.

Po ashtu ka realizuar kontakte me institucionet e nivelit qendror me qëllim të adresimit të kërkesave për respektim të ligjit dhe të Kushtetutës së vendit.

Në kuadër të projektit është organizuar debati i titulluar “Respektimi i ligjit në qeverisjen lokale”. Panelistë të tryezës ishin Ian Cliff, Ambasador i Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë, Ruzhdi Rexha, nën-kryetar i komunës së Prizrenit, Refki Reshitaj, gazetar i Zërit dhe Elmedina Baxhaku nga EC Ma Ndryshe. Diskutimi i tryezës u zhvillua rreth temës së respektimit të ligjit në qeverisjen lokale të Prizrenit dhe bashkëpunimin mes aktorëve relevant lokalë për arritjen e standardeve të qeverisjes demokratike.

Tryeza tjetër e diskutimit “Bashkëpunimi media – shoqëri civile për qeverisje transparente” si panelistë ka pasur Ismet Kryeziun, Drejtor ekzekutiv i Institutit Demokratik të Kosovës, Arben Ahmetin, Kryetar i Bordit të Asociacionit të Gazetarëve të Pavarur të Kosovës dhe Ymer Berishën, Udhëheqës i Zyrës për Informim në komunën e Prizrenit. Pjesëmarrës kanë qenë edhe përfaqësues të medieve, shoqërisë civile dhe të partive politike, të cilët janë pajtuar se nevojitet një angazhim më i madh dhe bashkëpunim më i afërt për rritjen e nivelit të transparencës. Në kuadër të tryezës ka lindur propozimi për themelimin e “Platformës Transparenca” në nivelin lokal, që do të funksiononte si mekanizëm i bashkëpunimit Shoqëri Civile-media për sigurimin e qeverisjes më transparente.

VIII. Ndikimi i projektit

Gjatë shtatë muajve të zbatimit të projektit Transparenca online e komunës së Prizrenit janë arritur rezultatet si në vijim: 15 komunikata për shtyp në çështjet që shtrihen nga urbanizmi e deri te shëndetësia dhe arsimi; 2 analiza mbi transparencën e qeverisë komunale dhe urbanizëm; 19 reagime publike, lajme dhe njoftime të shpejta mbi transparencën e qeverisë komunale; 15 njoftime nga takimet e kryetarit të komunës me drejtorët komunal; 3 debate mbi respektimin e ligjit nga qeveria lokale, bashkëpunimin media – shoqëri civile dhe urbanizmin; sikurse edhe konferenca periodike për shtyp. Këto aktivitete janë mbuluar nga mediet (lokale dhe nacionale) sipas të dhënave në vijim: rreth 80 TV kronika me afër 300 minuta; mbi 60 artikuj në gazeta me rreth 33 faqe, afër 150 raportime në ueb portale dhe rreth 130 minuta raportim në radio.

Projekti ka pasur ndikime të ndryshme mbi fushat që ka prekur. Dy nga më të rëndësishmet janë nisja e hetimeve nga Prokuroria Themelore për çështjet e urbanizmit dhe ngritja e aktakuzës për shpërdorimin e detyrës dhe autorizimeve ndaj zyrtarëve të lartë të qeverisë lokale të Prizrenit. Në të dyja rastet, projekti ka ofruar të dhëna të bazuara dhe i ka kontribuar zhvillimit të procedurave përkatëse nga ana e organeve të drejtësisë. Për më shumë, në saje të projektit janë mundësuar edhe dy reagime nga Qeveria e Kosovës, me ç’rast Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal i ka dërguar një shkresë kryetarit të komunës dhe kryesuesit të KK-së në lidhje me rastin “Dardania” respektivisht nevojën e zbatimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, derisa Ministri i Kulturës ka ofruar zotimin publik për mbrojtjen e Qendrës Historike të Prizrenit pas publikimit të një numri raportesh mbi degradimin urban në

këtë zonë. Projekti ka arritur që të tërheq vëmendjen e gjerë të publikut dhe të medieve mbi raportet që kanë vënë në pah shkatërrimin urban dhe mjedisor në zonën e Prevallës. Projekti ka arritur që të hap mbledhjet e qeverisë lokale, duke i ofruar publikut informata të menjëhershme mbi vendimet e marra nga ekzekutivi komunal. Në fund, projekti është bërë një pikë legjitime dhe e besueshme e qytetarëve, të cilët kanë adresuar dhe vazhdojnë që t'i paraqesin shqetësimet e tyre në raport me qeverisjen komunale.

IX. Për projektin

Ekzekutivi i komunës, i cili tashmë udhëhiqet nga kryetari i komunës (i cili i emëron dhe shkarkon drejtorët komunalë sipas vullnetit të tij personal), po promovon një cilësi të re të qeverisjes lokale dhe të ofrimit të shërbimeve publike. Ndonëse ky ndryshim nuk është gjithmonë pozitiv, ekzekutivi i komunës (sidomos kryetari) po shndërrohet në adresën e vetme të përgjegjësisë, dhe si pasojë të llogaridhënies, në raport me qeverisjen e mirë dhe shërbimet cilësore publike. Mbikëqyrja e punës së kryetarit (sidomos pjesa e ligjshmërisë) është ndër sfidat më të mëdha të qeverisjes lokale në Kosovë. Derisa Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal vlerësohet jo mjaftueshëm efektive, as Kuvendet Komunale dhe sistemi gjyqësor nuk dëshmojnë për cilësi më të larta. Dimensioi i fundit i kësaj mbikëqyrjeje, kontrolli qytetar, krahas pengesave politike, po has edhe në absurditete ligjore (Neni 72 i Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale për largimin e kryetarit nga detyra).

Janë evidentuar shumë raste gjatë këtyre dy mandateve të fundit, kur Kryetarë komunash kanë vepruar pa konsultim paraprak me

Kuvendin Komunal dhe në shumë raste pa vendim të këtij organi. Kjo praktikë ka ngritur shqetësime të shumta në raport me respektimin e ligjit nëpër komnatat e Kosovës.

Përkrahësit e sistemit mayoral janë të vetëdijshëm për formulën e dëmtimit të demokracisë në nivel lokal. Kjo formulë arrihet kur Kryetari i komunës tregohet shumë i sofistikuar në aftësitë e tij manipuluese, derisa në të njëjtën kohë Kuvendi Komunal tregohet i ngathtë në përmbushjen e obligimeve dhe ushtrimin e plotë të kompetencave (ligjore dhe mbikëqyrëse). Disa dyshime rreth keqpërdorimit të pushtetit ekzekutiv janë shfaqur në komunën e Prizrenit dhe zyrtarët e lartë komunal këtë vit po përballen me gjyqësorin, pasi që prokuroria e EULEX-it ka ngritur aktakuzë ndaj kryetarit dhe pesë bashkëpunëtorëve të tij nën dyshimin për shpërdorimin e detyrës zyrtare dhe të autorizimeve. Edhe Prokuroria e Qarkut të Prizrenit ka autorizuar Njësinë për Krime Ekonomike dhe anti-Korrupsion të Policisë së Kosovës për të hetuar disa raste të dyshimta në dikastere të ndryshme për korrupsion dhe shpërdorim të detyrës zyrtare nga zyrtarët e lartë komunal.

Për këtë arsye, monitorimi dhe raportimi për aktivitetet e keqqeverisjes (sidomos të ekzekutivit të komunës) do të duhej të ishte detyrë primare e shoqërisë civile në raport me qeverisjen e mirë në nivel lokal.

Transparenca online e komunës së Prizrenit është projekt për monitorimin e punës së organeve komunale. Fokusi themelor i monitorimit është ekzekutivi i komunës (kryetari i komunës dhe drejtoritë) si dhe shërbimi civil. Monitorimi bëhet përmes monitoruesve permanentë, të cilët kenë prezencë të rregullt në zyrat komunale dhe

qasje të papenguar në dokumentet zyrtare të komunës. Raportimi i të gjeturave të monitorimit përdorë gjithashtu një mekanizëm permanent, ueb-faqen e transparencës së qeverisjes lokale. Të gjeturat e monitorimit postohen drejtpërdrejtë në ueb-faqen e projektit, për të krijuar mundësi qasjeje për të gjitha palët e interesuara. Të gjeturat e monitorimit janë bazë e veprimit për nivelin e dytë të aktiviteteve të projektit, avokimin dhe adresimin e shkeljeve ligjore. EC Ma Ndryshe përdorë mundësitë ligjore për të nisur procedura të adresimit të shkeljeve ligjore nga ana e komunës.

Në gjashtë muajt e parë (mars-shtator 2012) projekti Transparenca online e komunës së Prizrenit është mbështetur nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS). Ndërsa nga shtatori i vitit 2012 vazhdimi i projektit është mundësuar në sajë të mbështetjes bujare të Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë.

Qëllimi themelor i projektit është forcimi i qeverisjes së mirë në komunën e Prizrenit. Objektivat specifike që do të ndihmojnë arritjen e këtij qëllimi janë: Përmirësimi i nivelit të informimit të përgjithshëm të publikut mbi vendimmarrjen lokale, Aktivizimi i mekanizmave qeveritarë dhe gjyqësorë për adresimin e praktikave që cenojnë ligjshmërinë, Rritja e nivelit të transparencës komunale në vendimmarrje, Rritja e vigjilencës së vendimmarrësve lokalë në raport me respektimin e ligjshmërisë në qeverisjen lokale, Rritja e pjesëmarrjes së grupeve të komunitetit në vendimmarrjen lokale.

X. Pse monitorim i transparencës?

Në dekadën e kaluar fokusi ndaj transparencës, si një aspekt i përmirësimit të qeverisjes dhe luftës kundër korrupsionit, ka qenë në nivel kombëtar, që lidhet kryesisht me prirjet globale të pluralizmit, demokratizimit dhe përmirësimit të qeverisjes. Në një aspekt, kjo është e kuptueshme, pasi që korrupsioni - pasojë më e spikatur e mungesës së transparencës – shpesh është më i dukshëm në nivel kombëtar, dhe për shkak se institucionet e legjislativit, ekzekutivit apo gjyqësorit kanë qenë pikë tradicionale e referencës për luftimin e korrupsionit. Kohët e fundit, megjithatë, ekziston një ndryshim në drejtim të rritjes së transparencës në nivel lokal.

Gjithnjë e më shumë po kuptohet rëndësia e ndërtimit të transparencës në nivel lokal si mjet për trajtimin e disa nga sfidave më të mëdha për zhvillimin e qëndrueshëm dhe demokracinë. Janë dy aspekte themelore të qeverisjes (dhe qeverisjes së mirë). Së pari, koncepti i qeverisjes është më i gjerë se qeveria. Në kontekstin urban, kjo do të thotë se përgjegjësia për menaxhimin e çështjeve të një qytetit nuk është e kufizuar në pushtetin lokal, por përfshin një shumëllojshmëri të gjerë të palëve të interesuara, duke përfshirë: qeverinë qendrore dhe lokale, sektorin privat, organizatat e shoqërisë civile dhe ato të bazuara në komunitet, mediet, shoqatat profesionale dhe anëtarë të tjerë të shoqërisë civile. Së dyti, koncepti i qeverisjes fokusohet në institucionet dhe proceset. Në kontekstin e burimeve të pakta, që konkurrojnë, por të vlefshme, prioritetet duhet të vendosen me anë të proceseve që përfshijnë të gjitha palët e interesuara në vendimmarrje. Kjo ka implikime të rëndësishme për zhvillimin e një kornize për promovimin e transparencës në nivel lokal.

Transparenca në proceset vendimmarrëse dhe në institucione ka potencial të bëhet një strategji qendrore për t'u angazhuar aktorët, luftën kundër korrupsionit dhe përmirësimin e cilësisë së qeverisjes urbane në përgjithësi. Prandaj, transparenca paraqet parimin thelbësor të qeverisjes së mirë. Qasja e lirë në informata luan një rol të rëndësishëm në promovimin e transparencës. Informacioni, megjithatë, duhet të jepet në kohë, të jetë relevant, i saktë dhe i plotë për t'u përdorur në mënyrë efektive. Çështjet se kush e prodhon atë informacion, dhe për çfarë qëllimi, bëhen aspekte kyçe të transparencës, kur interesat konkurrense konvergojnë në një çështje të veçantë. Një nga modelet më të avancuara për sigurimin e transparencës është korniza pesëpikëshe për rritjen e transparencës: 1. Vlerësim dhe monitorim, 2. Qasje në informacion, 3. Etikë dhe integritet, 4. Reformë institucionale dhe 5. Trajtimi i çështjeve specifike.

XI. Falënderim

EC Ma Ndryshe është thellësisht mirënjohëse ndaj Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë, që ka vlerësuar këtë projekt dhe ka vendosur ta mbështesë financiarisht duke filluar nga muaji shtator 2012. Po ashtu ka mundur të vendosjen e dialogut me ekzekutivin e komunës, të cilët në fazën e dytë janë treguar më të hapur në ofrimin e qasjes në dokumentet zyrtare, për të cilën gjë po ashtu jemi mirënjohës. Një falënderim i veçantë i takon edhe Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur, që ka ofruar mbështetje financiare për fazën e parë (testuese) të projektit “Transparenca online e komunës së Prizrenit”, e cila përkrahje ka qenë thelbësore në konsolidimin e këtij projekti.

EC Ma Ndryshe

Organizata jo-qeveritare “Emancipimi Civil Ma Ndryshe” u themelua në mars të vitit 2006. Qëllimet kryesore të organizatës janë: promovimi i qytetarisë aktive dhe pjesëmarrëse dhe ngritja e vetëdijes qytetare për mbrojtjen dhe kultivimin e trashëgimisë kulturore. EC Ma Ndryshe është ndër themelueset dhe përfaqëson Kosovën në Rrjetin e Evropës Juglindore të organizatave që merren me trashëgimi kulturore – SEE Heritage Network. Gjithashtu, është themeluese e Forumit të Trashëgimisë Kulturore të Prizrenit, Rrjetit të Organizatave Kulturore të Prizrenit dhe Rrjetit të Organizatave të Pavarura të Kulturës në Kosovë – Forumi Kulturor. EC Ma Ndryshe, që nga themelimi më 2006 është duke ushtruar presion direkt ndaj qeverisë lokale në Prizrenit për të krijuar qasje shoqërisë civile dhe qytetarëve për bashkë vendimmarrje. Përveç pjesëmarrjes direkte në proceset e konsultimeve publike, EC Ma Ndryshe ka avokuar rregullisht për respektimin e obligimeve ligjore për konsultime publike, përfshirjen sa më të gjerë komunitare në konsultime publike dhe përfshirjen e shqetësimeve dhe kërkesave të komunitetit në dokumentet e politikave publike.

Projektet kryesore: Pjesëmarrja qytetare përmes medias sociale në Prizren dhe Gjilan (2013 – 2014), Qyteti gjithëpërfshirës – planifikimi me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren (2013 – 2015), Trashëgimia kulturore, shtyllë qendrore për zhvillim të qëndrueshëm lokal dhe rajonal në Prizren (2013 – 2014), Vullnetarët e Kulturës (2012 – 2013), Pjesëmarrja qytetare në hartimin dhe zbatimin e politikave kulturore në komunën e Prizrenit (2012 – 2013), Transparenca online e komunës së Prizrenit (2012), Roli i shoqërisë civile në promovimin e trashëgimisë kulturore (projekt rajonal) 2011 – 2013, Një përrallë ballkanike, trashëgimia otomane në Ballkan (projekt rajonal) (2011 – 2013), Ngritja e vetëdijes kulturore tek të rinjtë përmes dokumentarëve (2010), Forcimi i veprimit qytetar për promovim dhe mbrojtje të trashëgimisë kulturore (2009), Platforma “Culture 2013” (2008 – 2009), Kampet e Restaurimit (2007, 2008 & 2009), Forumet e Hapura Qytetare (2007), Ditët e Trashëgimisë Evropiane në Kosovë (2006, 2007 & 2008), Zambaku i Prizrenit 2006.

Publikimet: Pjesëmarrja qytetare në hartimin e politikave kulturore në Prizren (pritet të publikohet në qershor 2013), Kush mbikëqyr mbikëqyrësit – llogaridhënia e shoqërisë civile në Kosovë (pritet të publikohet në Maj maj 2013), Gabim pas gabimi – analizë mbi gabimet e panumërta dhe të vazhdueshme në trashëgimi kulturore (2013), Katër analiza të projektit “Online Trasparency”: 1. Degradimi Natyror dhe Urbanistik, 2. Respektimi i ligjit në qeverisjen lokale, 3. Qeverisja e mirë nuk është fjalë goje, 4. Transparenca e qeverisjes lokale ne Prizren (2012 – 2013), Silent Balkan, film dokumentar i projektit “A Balkan Tale” (2012), Jeta kulturore në komunën e Prizrenit (në bashkëpunim me Teatrin ODA) (2010-2011), Prizreni në Retrovizorë, krahasim i fotografive të vjetra dhe të reja të Prizrenit (2009), Vullnetarizmi dhe Trashëgimia Kulturore (2009), Intervenimi me kosto të ultë (2009), Dokument Strategjik mbi Organizimin e Ditëve të Trashëgimisë Evropiane në Kosovë (2008), Trashëgimia Kulturore dhe Turizmi Kulturor në Prizren (2008), Hapësirat Kulturore në Kosovë (në bashkëpunim me Teatrin ODA) (2008).